



4 European
Union
Kosovo

QËNDRIM PËR GRANTIN SPECIFIK PËR SHËRBIME SOCIALE



Maj 2020





Qëndrimi për Grantin Specifik për Shërbime Sociale dhe Familjare është hartuar nga Grupi Tematik për Mbrojtje të Fëmijëve në kuadër të Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF, në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës.

Dokumenti përmban propozimin dhe arsyetimin për krijimin dhe përfshirjen e këtij granti në kuadër të Ligjit të ri për Financat e Pushtetit Lokal. Ky qëndrim do t'i prezantohet dhe vijë në ndihmë Ministrisë së Financave dhe Transfereve e cila është bartëse e procesit të hartimit të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Qëndrimi i përbashkët mes KOMF, Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës, do të jetë gjithashtu edhe në dispozicion të gjithë partnerëve, institucioneve dhe palëve të tjera të interesit.



Ky qëndrim është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit European. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit European.

Qëndrimi për Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare u hartua në kuadër të projektit "Aksioni i Përbashkët për Decentralizim" (Joint Action for Decentralization), financuar nga Bashkimi European, menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë dhe implementuar nga KOMF në partneritet me SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Organizatën për Fëmijët pa Kujdes Prindëror OFAP dhe KMOP.



Hyrje

Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2019 ka miratuar Koncept Dokumentin për Financat e Pushtetit Lokal, i cili i hapi rrugë krijimit të Grantit Specifik për Shërbime Sociale.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF ka dërguar rekomandimet në kuadër të konsultimeve publike për Koncept Dokumentin për Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal. KOMF ka propozuar krijimin e Grantit Specifik për Shërbime Sociale me qëllim të sigurimit të financimit të qëndrueshëm dhe të drejtë të shërbimeve sociale. Për të siguruar një financim të qëndrueshëm dhe të drejtë të shërbimeve sociale në Kosovë, KOMF ka rekomanduar që Granti Specifik për Shërbimet Sociale të jetë i llojit të mbyllur, e cila është alternativë më adekuate për arsye se siguron një minimum të sigurt të ofrimit të shërbimeve sociale. Përkundër kërkesave të shoqërisë civile që Granti Specifik të jetë i llojit të mbyllur, si alternativë më adekuate për sigurimin e një minimumi të ofrimit të shërbimeve sociale, sipas koncept dokumentit të aprovuar, Granti Specifik për Shërbime Sociale parashihet të jetë grant me sistem të hapur.

Miratimi i Koncept Dokumentit për Financat e Pushtetit Lokal përbën një hap shumë të rëndësishëm drejt zgjidhjes së problemit për sigurimin e financimit të qëndrueshëm të shërbimeve sociale. Bazuar në Koncept Dokumentin e miratuar, gjatë vitit 2019 është hartuar Ligji i ri për Financat e Pushtetit Lokal ku është paraparë krijimi i Grantit Specifik për Shërbime Sociale.

Projektligji ka kaluar fazën e konsultimeve publike, megjithatë për shkak të rënies së Qeverisë dhe shpërbërjes së Kuvendit të Kosovës, Projektligji nuk është miratuar ende nga Qeveria dhe Kuvendi.

KOMF në vazhdimësi gjatë pesë viteve të fundit ka avokuar fuqishëm drejt vendimmarrësve për krijimin e Grantit Specifik për Shërbime Sociale, si zgjidhje e problemit të financimit të shërbimeve sociale. Konkretisht, KOMF gjatë pesë viteve të fundit ka adresuar rekomandimet për zgjidhjen e problemit të financimit të shërbimeve sociale përmes krijimit të Grantit Specifik për Shërbime Sociale, drejt Kryeministrit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komisioneve Parlamentare, komunave, etj. Kjo është adresuar edhe përmes publikimit të Analizave Buxhetore për Financimin e Shërbimeve Sociale (2014 – 2018) si dhe hulumtimeve, sikurse Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijëve (2016 - 2018).



KOMF mbetet i përkushtuar të kontribuojë më tutje në përmbylljen e këtij procesi, me qëllim sigurimin e qëndrueshëm të financimit të shërbimeve sociale.

Financimi i shërbimeve sociale në komuna


1 Grant i Përgjithshëm

2 Grante Specifike

Ligji për Financat e Pushtetit Lokal në fuqi, rregullon transferet në komuna nëpërmjet tre granteve kryesore: Grantit të Përgjithshëm, dhe dy Granteve Specifike – të caktuara për arsimin parauniversitar dhe për shëndetësinë primare. Granti i përgjithshëm ka për qëllim t'ju sigurojë komunave një burim bazë për të mundësuar që ato të kryejnë funksionet e tyre në mënyrë adekuate, duke i plotësuar ato me të hyrat e tyre vetanake, të cilat në thelb janë shumë të kufizuara. Ligji siguron që formulat të rishikohen rregullisht, fillimisht dy vite pas miratimit të ligjit dhe çdo tre vite pas rishikimit të parë.

Shërbimet sociale janë kompetencë vetanake komunale dhe bazuar në LFPL financohen nga komunat përmes dy burimeve të financimit nga granti i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake komunale. Granti i përgjithshëm ka për qëllim t'ju sigurojë komunave një burim bazë për të mundësuar që ato të kryejnë të gjitha funksionet e tyre në mënyrë adekuate duke i plotësuar ato me të hyrat vetanake, të cilat në thelb janë shumë të kufizuara. Granti i përgjithshëm është grant i tipit të mbyllur me 10% të të hyrave të projektuara që do të duhen të mblidhen në nivel qendror gjatë një viti kalendarik, ndërsa ndarjes për kokë banori i janë shtuar disa parametra shtesë, që në radhë të parë të ndihmojë komunat e vogla me diversitetin etnik dhe territorial të komunave.

Granti i Përgjithshëm



Mirëpo problemi për shërbime sociale fillon pikërisht këtu, sepse nuk ka garanci që do të ketë ndarje të mjaftueshme në mënyrë që të sigurohet minimumi i financimit për shërbimet sociale. Kjo sepse nga këtu nuk ka ndonjë mekanizëm të ndarjes për shërbimet sociale, duke ditur se nga këto shuma buxhetojnë të gjitha departamentet për shpenzimet operative dhe kapitale.

Në pamundësi që të sigurohet një mekanizëm i qëndrueshëm për financimin e shërbimeve sociale çështja është shndërruar në problem kritik ekzistencial për mbarëvajtjen e Qendrave për Punë Sociale dhe organizatave jo-qeveritare ofruese të shërbimeve sociale.



Sipas Raportit të Monitorimit të KOMF për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale, financimi total nga Granti i Përgjithshëm për vitin 2019, për të gjitha QPS-të dhe për të gjitha kategoritë e shpenzimeve, ka qenë



rreth 6 milionë Euro

ku janë përfshirë kostot e pagave të stafit të QPS-ve dhe shpenzimet e tjera operative.

Ky raport monitorimi tregon se komunat mbulojnë vetëm pagat mujore dhe shpenzimet administrative për shërbimet sociale. Në përgjithësi komunat nuk ndajnë buxhet për QPS-të, për ofrimin e shërbimeve sociale të bazuar në nevojat e qytetarëve brenda komunave. Në anën tjetër, komunat nuk kanë krijuar një skemë të qëndrueshme të kontraktimit për blerjen e shërbimeve sociale nga sektori jo-qeveritar. Mbështetja e komunave mbetet ad hoc dhe varion nga komuna në komunë.



Në mënyrë që ky funksion komunal të mos mbetet në mëshirë të nivelit komunal (duke pasur parasysh financimin në vitet e fundit), sugjerohet të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme e financimit brenda Ligjit për Financimin e Pushtetit Lokal përmes krijimit të Grantit Specifik për Shërbime Sociale.

Propozim

Me qëllim të sigurimit të financimit të qëndrueshëm dhe të drejtë të shërbimeve sociale në Kosovë, KOMF propozon:



Krijimin e Grantit Specifik për Shërbime Sociale në kuadër të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Ky grant duhet të jetë krahas granteve për arsim dhe shëndetësi si grant specifik për shërbime sociale. Granti Specifik për Shërbime Sociale do të duhet të përmbajë kriteret e qarta në mënyrë që të sigurojë ndarje të drejtë dhe financim adekuat për shërbimet sociale. Për të siguruar mirëqenien dhe ofrimin e shërbimeve bashkëkohore, rekomandohet që LFPL të orientohet sipas njëres nga dy alternativat e KOMF:

Alternativa I:

Grant Specifik për Shërbime Sociale i llojit të mbyllur, e cila është alternativa më adekuate për arsye se siguron një minimum të sigurt të ofrimit të shërbimeve sociale.

Alternativa II:

Grant Specifik për Shërbime Sociale i llojit të hapur. Duhet cekur që alternativa e dytë nuk garanton siguri financiare në masë sikurse alternativa e parë.

Vlera e Grantit Specifik për Shërbime Sociale duhet të përcaktohet duke marrë parasysh faktorët/kriteret në territorin e një komune sikurse



numrin e qendrave për punë sociale, numrin e qendrave rezidenciale, strehimoreve dhe qendrave ditore sipas standardeve të përcaktuara nga niveli qendror, numrin e punëtorëve social në përpjesëtim me numrin e banorëve dhe numrin e rasteve, numrin e fëmijëve në bazë të grupmohave dhe të rriturve të cenuar apo rrezikuar; numrin e viktimave të dhunës në familje, trafikimit dhe abuzimit, numrin e personave me nevoja të veçanta, numrin e personave të moshuar mbi moshën 65 vjeç dhe numrin e familjeve në asistencë sociale në relacion me sipërfaqen e territorit komunal.¹

1. Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal, <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40711>

Arsyetimi

- Përkundër decentralizimit të shërbimeve sociale të bërë nga 1 Janari 2009, komunat kanë bërë pak veprime konkrete për të ndarë buxhet për ofrimin e shërbimeve sociale në komunën e tyre. Komunat nuk kanë krijuar një skemë të qëndrueshme të kontraktimit për blerjen e shërbimeve sociale nga sektori jo-qeveritar. Mbështetja e komunave mbetet ad hoc dhe varion nga komuna në komunë. Mungesa e një granti specifik për komunat për shërbimet sociale pamundëson ofrimin e shërbimeve cilësore minimale për mbrojtjen e qytetarëve dhe pengon mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të tyre. Kjo i pamundëson institucionet komunale në përmbushjen e mandatit dhe obligimeve të parapara me legjislacionin në fuqi. Nëse vazhdohet me këtë formë të financimit gjendja mund të keqësohet për aq sa të shndërronjë Qendrat për Punë Sociale në qendra jofunksionale, të cilat duke mos u financuar mjaftueshëm nuk do të mund të ofrojnë shërbime sociale. Në mënyrë që ky funksion komunal të mos mbetet në mëshirë komunale (duke pasur parasysh financimin në vitet e fundit), sugjerohet të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme e financimit brenda Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.
- Sipas Raportit të Monitorimit të KOMF për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale, mungesa e decentralizimit të buxhetit për shërbime sociale ka shkaktuar një gjendje shumë të rëndë të ofrimit të këtyre shërbimeve. Aktualisht, nuk është bërë kostimi i shërbimeve (standardet financiare), nuk është hartuar formula e financimit për shërbime sociale dhe nuk është krijuar plani për financim të qëndrueshëm të shërbimeve sociale nga MPMS dhe Komunat.
- Të dhënat e fundit të cilat institucionet e Kosovës kanë në dispozicion, flasin për një shkallë të lartë të përfshirjes së fëmijëve në punë, ku 10.7% e fëmijëve në Kosovë janë të përfshirë në punë, përderisa 6.8% e fëmijëve punojnë në kushte të rrezikshme. 61.4% e fëmijëve deri në moshën 14 vjeç kanë pësuar nga dhuna psikologjike dhe fizike. Fëmijët me aftësi të kufizuara nuk i realizojnë plotësisht të drejtat e tyre në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Rreth 1200 fëmijë janë pa përkujdesje prindërore, të strehuar tek të afërmit, në strehim familjar apo strehim rezidencial.
- Financimi i shërbimeve sociale në Kosovë mbetet objekt i kritikave në raportet ndërkombëtare. Kjo është reflektuar edhe në Raportin e Progresit të BE për vitet e fundit. Sa i përket mbështetjes financiare, raporti thekson se Kosova duhet të sigurojë që komunat të kenë burime të mjaftueshme për të ofruar shërbime sociale brenda përgjegjësive të tyre, njëherit alokimi i buxhetit duhet të bëhet në mënyrë që të ketë decentralizim efektiv. Rekomandohet që zgjidhja të bëhet përmes përcaktimit të buxhetit për shërbime sociale në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal.

Propozimet e KOMF janë në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të legjislacionit në fuqi

01

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në Nenin 50, ka paraparë të drejtat e fëmijës, ndër të tjera atë se fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre si dhe se të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërrmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.

02

Ligji Nr. 2004/32 për Familjen, Neni 2, përcakton që Familja është bërthamë natyrore dhe themelore e shoqërisë dhe si e tillë gëzon të drejtën në mbrojtje. Më tutje, Neni 5 definojnë që fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, si dhe prindërit të cilët nuk janë të aftë të krijojnë kushtet e domosdoshme jetësore për vete dhe për fëmijët e tyre, janë nën përkrahjen e veçantë financiare dhe shoqërore.

03

Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, përcakton që në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare. Neni 6, paragrafi 6.1 i Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, përcakton që secila komunë, përmes Drejtorisë përkatëse, është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të saj, sipas standardeve të specifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

04

Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kreu III, Neni 16 përcakton që Komunitat ushtrojnë kompetencat e tyre vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara në pajtim me ligjin. Neni 17 përcakton që komunitat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm në fushat e ndryshme, përfshirë: Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut; Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimi familjar dhe përkujdesi fëmënor.



Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, i themeluar në 2011, është koalicioni i përbërë nga 31 organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Organizatat anëtare të KOMF: Asociacioni për Trajtime Sociale, Hulumtime dhe Avokim – ASTRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, Balkan Sunflowers Kosova, Childproof/CIPOF, Education Comes First – ECF, Iniciativa 6, Organizata Rinore Akti – Ora, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile – CRP/K, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara – FIT, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS, Terre des hommes, The Ideas Partnership, VoRAE, World Vision, Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS, Network of Peace Movement – NOPM, Qendra Sociale – Edukative SOS Kopshti, Nevo Koncepti, Qendra Labyrinth dhe Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë (PEN).



Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve

Zenel Salihu, OB.1 HY.1 K.3 No.16, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 220 287

info@komfkosova.org

www.komfkosova.org

Financuar nga:



European
Union
Kosovo

Implementuar nga:

